

Në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/'18, 178/'21, 58/'24), Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit të Administrimit të Biznesit dhe Udhëzuesin me kriteret për realizimin e zgjedhjeve për anëtarët dhe për kryetarin e Kuvendit Studentor të Fakultetit të Administrimit të Biznesit, shpallet:

KONKURS

për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Administrimit të Biznesit

- I. Të drejtë për të aplikuar kanë të gjithë studentët që e kanë regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2024/2025, duke përfshirë edhe studentët që kanë regjistruar semestrin veror të zbrazët në vitin akademik të lartpërmendur.
- II. Së bashku me Fletaplikimin (formularin), kandidatët dorëzojnë:
 - biografi (CV),
 - vërtetim nga shërbimi për çështje studentore se kandidati e ka regjistruar semestrin veror në vitin akademik 2024/2025,
 - vërtetim për notë mesatare prej së paku 8 për kandidatin për kryetar.
- III. Kandidatët për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të Kuvendit Studentor të Fakultetit janë të detyruar që personalisht t'i dorëzojnë fletaplikimet me dokumentet përkatëse, përmes arkivit të Fakultetit ose me postë në adresën: Universiteti i Tetovës (Fakulteti i Administrimit të Biznesit) rr. "11 Nëntori", p.n., Bedinje, 1300, Kumanovë, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve nga shpallja e njoftimit, respektivisht më së voni deri më 20.06. 2025.
- IV. Aplikimet e vonuara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Komisionit Zgjedhor

Prof.Dr.Naser Raimi

